

VENDIM
Nr.438, datë 13.7.2007

PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 35 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Paga bazë për gradë (kolona 3), e lidhjes nr.1, është niveli i pagës së punonjësit të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, në përputhje me gradën, që ka fituar.
 3. Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi (kolona 4) e lidhjes nr.1 jepet sipas funksioneve të veçanta të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.
 4. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.
 5. Vendimi nr.54, datë 27.2.1992 i Këshillit të Ministrave “Për sistemin e pagave të Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar, duke filluar nga data 1 korrik 2007, nuk do të zbatohet për punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.
 6. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi
1	2	3	4
Bazë	Agjent	31350	7000
	Agjent i I-rë	32400	7000
	Asistent	33600	8000
	Asistent i I-rë	35000	8000
	Kryeasistent	36100	8000
I Mesëm	Nëninspektor	46000	6000
	Inspektor	48300	6000
	Kryeinspektor	54250	6000
I lartë	Nënkomisar	65900	6000
	Komisar	80900	6000
	Kryekomisar	92400	6000
Madhor	Drejtues	102000	
	Drejtues i I-rë	109500	